



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.03/2017
Prishtinë, më 24.10.2017, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha – Shala, kryetare, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari – Lila, Memli Krasniqi, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Dardan Molliqaj, Qëndron Kastrati dhe Gani Dreshaj, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Etleva Malushaj –GPP/ LVV dhe Dardan Abazi – INDEP.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha - Shala, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1.Miratimi i rendit të ditës;
- 2.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 17.10.2017;
- 3.Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016;
- 4.Shqyrtimi i Projektplanit të Punës së Komisionit;
- 5.Të ndryshme;

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Sala Berisha-Shala, kryetare, propozoi që pika e tretë (3)“Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016” të hiqet nga rendi i ditës sepse pas konsultimit me z. Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë i Komisionit, u pajtuam që të shtyhet për mbledhjen e radhës pasi që është një raport voluminoz dhe merr kohë më të gjatë për ta analizuar. Ndërsa, propozoi që të zëvendësohet me një pikë tjetër rendit i ditës:“Formimi i grupit të punës për nismën legjislative “Projektligji për miniera dhe minerale”.

Rendi i ditës u miratua me propozim të kryetares.

2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 17.10.2017;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 17.10.2017, u miratua pa vërejtje.

3.Formimi i Grupit të Punës për nismën legjislative “Projektligji për miniera dhe minerale”;

Sala Berisha-Shala - Për këtë nismë kemi diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar, kur u shqyrtua projektplan i punës së komisionit, ku ju njoftova së është komplet i përgatitur “Projektligji për miniera dhe minerale”dhe ka qenë në fazën kur duhet të kthehet mendimi nga Qeveria, por për shkak të shpërbërjes së Kuvendit është prolonguar procesi. Pra nisma legjislative është e gatshme. Tani vetëm kërkoj që të bëhet propozimi i grupit të punës për hartim.

Hykmete Bajrami - Kërkoj të dijë se a ka pas konsultim të jashtëm në kohën e hartimit të nismës ligjore?

Pas debatit,Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

V E N D I M

- 1.Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, do të hartojë Projektligjin për Minierat dhe Mineralet.*
- 2. Themelohet Grupi i Punës, në këtë përbërje: Sala Berisha – Shala, kryesuese, Dardan Sejdiu, Mimoza Kusari-Lila, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, si bartës të procesit të hartimit të projektligjit.*
- 3. Grupi i punës do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet, si dhe mekanizmat tjerë për hartimin e këtij projektligji.*
- 4. Secili anëtarë i Komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjitet grupit të punës, gjatë punës së tij.*
- 5. Grupi i Punës, në bashkëpunim me Njësinë koordinuese të Komisionit, do të hartojë planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim, për shqyrtim dhe miratim në Komision.*
- 6. Shpenzimet për punën e Grupit të Punës për zbatimin e këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i Komisionit, respektivisht nga buxheti i Kuvendit.*

4. Shqyrtimi i Projektplanit të Punës së Komisionit;

Kryetarja - Nga mbledhja e kaluar kanë dalë disa propozime për disa ndryshime, për këto propozime jemi takuar paraprakisht edhe me zëvendëskryetarin Dardan Sejdiu. Jemi pajtuar me këto ndryshime dhe para vetës e kemi draftin përfundimtar. Gjatë kësaj periudhe nëse ka ndonjë çështje urgjente, ne mund ta kemi edhe ndonjë pike tjetër jashtë Planit të Punës së Komisionit.

Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Plani i Punës së Komisionit për periudhën tetor – dhjetor 2017.

4. Të ndryshme.

Kryetarja, i njoftoi anëtarët e Komisionit në lidhje me kërkesën për sqarimin e vendimit të Qeverisë së Kosovës për shkarkimin e drejtorëve të Bordit të KOSTT sh.a, të cilën ngarkohet Komisioni që ta shqyrtojë. Ajo propozoi që për këtë kërkesë të kërkohej një opinion ligjor nga Zyra Ligjore e Kuvendit se si ka rrjedh procesi i shkarkimit të drejtorëve të Bordit të KOSTT-it, dhe a është i ligjshëm ky vendim dhe pastaj mund ta shqyrtojmë ne si komision, por edhe kur ta shqyrtojmë raportin vjetor të KOSTT-it.

Mimoza Kusari –Lila- Pajtohem plotësisht që kur të shqyrtohet raporti vjetor i KOSTT-it, të kërkohej sqarime për këtë çështje, si dhe të kërkohej sqarim po ashtu dhe opinion ligjor nga Departamenti Ligjor i Kuvendit, në lidhje me shkarkimin e drejtorëve të Bordit të KOSTT-it.

Hykmete Bajrami - Propozoj që t'i behet një kërkesë Drejtorisë Ligjore të Kuvendit dhe Zyrës Ligjore të Qeverisë, që është në kuadër të ZKM-së, për të kërkuar sqarime shtesë se si është marrë ky vendim i Qeverisë së Kosovës për shkarkimin e drejtorëve të Bordit të KOSTT-it.

Memli Krasniqi- Bordi i Drejtorëve të KOSTT-it është i zgjedhur me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe logjika thotë se ai që të ka emëruar edhe mund të shkarkojë.

Pas debatit, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Të kërkohej nga Administrata e Kuvendit opinion ligjor në lidhje me kërkesën e palëve rreth shkarkimit të drejtorëve të Bordit të KOSTT-it.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetare e Komisionit,

Sala Berisha – Shala
